



REPUBLIC OF ALBANIA



ALBANIAN CIVIL AVIATION AUTHORITY

INFORMATION BULLETIN

ACAA-DAS-IB-No.001

Issue: 01, Revision 00

Date: 26.05.2026



Accepted by:

Maksim Et'hemaj

Executive Director of Albanian Civil Aviation Authority

0.1 Record of Amendments

The table below describes the dates and reason for the different amendments of the current procedure. A vertical black line on the left-hand side of the page identify the changes with the previous version.

Issue No.	Revision No.	Date	Amended by	Reason
01	00	26.05.2026		Initial Issue

0.2 Revision table

Page #.	Issue No.	Revision No.	Date	Edited by

Njoftim: Shërbimet ajrore ndërkombëtare mbeten të sigurta në mes të shpërthimit të Ebolës

ICAO thekson rëndësinë kritike të respektimit të protokolleve shëndetësore dhe udhëzimeve të OBSH-së

Shënim – Ky version përditëson udhëzimet e OBSH-së të detajuara në shtojcë

MONTREAL, 25 Maj 2026 - Ndërsa shërbimet ajrore ndërkombëtare mbeten të sigurta, Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO) po u bën thirrje qeverive dhe palëve të interesuara në aviacion të respektojnë rreptësisht rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për të zbutur çdo risk të lidhur me shpërthimin aktual të Ebolës.

Që nga pandemia e COVID-19, ICAO ka vendosur protokolle të reja për shkëmbim të shpejtë dhe të standardizuar të informacionit mes shteteve, linjave ajrore, aeroporteve dhe agjencive shëndetësore. Aneksi 9 i Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar - Lehtësimi - ka një kapitull të ri mbi Dispozitat shëndetësore, dhe materiali përkatës udhëzues është përfshirë në Manualin e Lehtësimit të ICAO (Dok. 9957). Inovacionet digjitale, si deklaratat elektronike shëndetësore dhe proceset pa kontakt në kufi, janë integruar në rekomandimet e ICAO për të gjurmuar dhe menaxhuar risqet shëndetësore në mënyrë më efektive.

Nëpërmjet Marrëveshjes Bashkëpunuese për Parandalimin dhe Menaxhimin e Ngjarjeve të Shëndetit Publik në Aviacionin Civil (CAPSCA), ICAO po koordinon me OBSH-në dhe Shtetet Anëtare për të ofruar masa zbutëse të bazuara në risk dhe të mbështetura nga provat, me qëllim parandalimin e transmetimit të sëmundjes nëpërmjet udhëtimeve ajrore, duke mbrojtur shëndetin e personelit të aviacionit dhe pasagjerëve, duke siguruar udhëtarët dhe duke ruajtur lidhshmërinë ajrore thelbësore. ICAO do të vazhdojë të monitorojë nga afër situatën dhe do të lëshojë përditësime kur të jetë e nevojshme për Shtetet Anëtare dhe palët e interesuara në aviacion, në përputhje me udhëzimet e OBSH-së dhe sipas zhvillimit të situatës. Përditësimet do të publikohen në faqen e internetit të CAPSCA dhe do t'u dërgohen anëtarëve të CAPSCA.

Udhëzimet aktuale nga OBSH-së mbi Ebolën (Përditësuar më 25 Maj 2026 në orën 15:00 UTC -4)

Shpërthimi aktual i Ebolës në Republikën Demokratike të Kongos (RDK) dhe Ugandë është shkaktuar nga virusi Bundibugyo, i cili nuk përhapet nëpërmjet kontaktit rastësor apo nëpërmjet ajrit. Transmetimi ndodh nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me gjakun ose lëngjet e tjera trupore të një personi të infektuar.

Më 17 Maj 2026, Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) përcaktoi se shpërthimi përbën një Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare (PHEIC). Raste të konfirmuara në laborator të sëmundjes nga virusi Bundibugyo (BVD) janë raportuar në Provincën Ituri, RDK. Uganda ka raportuar gjithashtu raste të kufizuara të konfirmuara, të cilat konsiderohen si të lidhura me udhëtimet ndërkufitare nga RDK. Autoritetet kombëtare shëndetësore në RDK dhe Ugandë, të mbështetura nga OBSH dhe partnerë ndërkombëtarë, kanë zbatuar masa kontrolli të shpërthimit, duke përfshirë zbulimin dhe izolimin e shpejtë të rasteve, forcimin e mbikëqyrjes, parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve, gjurmimin e kontakteve, angazhimin e komunitetit dhe kontrollin në pikat e hyrjes si aeroportet dhe pikat kufitare.

Takimi i parë i Komitetit të Urgjencës së OBSH-së u mbajt më 19 Maj 2026. Komiteti ra dakord me vendimin për të shpallur shpërthimin aktual si PHEIC dhe jo si pandemi sipas dispozitave aktuale të RSN-së. Komiteti ka lëshuar rekomandime të përkohshme për Shtetet dhe Palët përkatëse për t'iu përgjigjur ngjarjes. Aktualisht, OBSH vlerëson riskun e transmetimit në nivele të ndryshme, duke ofruar këshilla specifike për vendet ku ndodh

ngjarja, për vendet me kufij të përbashkët dhe për vendet e tjera. Risku i transmetimit në nivel global konsiderohet të jetë i ulët.

Këshilla aktuale e OBSH-së në lidhje me udhëtimet ndërkombëtare përfshin faktin se vendet nuk duhet të mbyllin kufijtë apo të vendosin kufizime mbi udhëtimet dhe tregtinë, dhe se autoritetet kombëtare duhet të bashkëpunojnë me linjat ajrore dhe industrinë e tjera të transportit dhe turizmit për të siguruar që ato të mos tejkalojnë këshillat e OBSH-së mbi trafikun ndërkombëtar.

Kontrolli i hyrjes jashtë rajonit të prekur nuk konsiderohet i nevojshëm për pasagjerët që kthehen nga zonat në rrezik. Në vendet ku ndodh ngjarja, kontrolli i daljes mund të zbatohet për personat në aeroportet ndërkombëtare me sëmundje të pashpjegueshme që paraqesin ethe dhe simptoma të tjera në përputhje me BVD-në e mundshme. Autoritetet shëndetësore duhet të sigurojnë që rastet e konfirmuara dhe kontaktet e BVD-së të izoloohen dhe që individë të tillë të mos ndërmarrin udhëtime ndërkombëtare, përveçse kur bëhet fjalë për evakuim mjekësor.

Shënim – Kontrolli përkufizohet si "identifikimi supozuar i sëmundjes ose defektit të pazbuluar nëpërmjet aplikimit të testeve, ekzaminimeve ose procedurave të tjera që mund të aplikohen shpejt"